



PRANUAR ME:

ACCEPTED ON: 31/01/2024

PRIMLJENO

Nr. Nr. B: 02/43



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS



Kryesuesi i Kuvendit

Nr.02/

Datë: 31.01.2024

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 40 paragrafi 2 shkronja (d.), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/ 15, qeshor 2008", në bazë të nenit 13, nenit 23, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.02/441 datë:14.09.2023, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -I- (parë) të rregullt të mbajtur me datë: 26.01.2024 merr këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË KOMITETIT PËR ARSIM KULTURË RINI DHE SPORT PËR VITIN 2023

1. Miratohet Raporti nr.02/21 datë 12.01.2024 i Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport për vitin 2024.
2. Raporti përfshinë gjithë punët dhe aktivitetet që janë organizuar në vitin 2023 nga Komitetit për për arsim, kulturë, rini dhe sport.
3. Pjesë përbërse e këtij vendimi është Raporti të Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport për vitin 2023.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kuvendi i Komunës, përmes Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport .
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në auteritetin mbikqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, dhe pas shpalljes ne ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :

MAPL-së

Arkivit të Komunës





PRANUAR ME
ACCEPTED ON 31/01/2024
PRIMJENJ
Nr. 02/43



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kryesuesi i Kuvendit

Nr.02/_____

Datë: 31.01.2024

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 40 paragrafi 2 shkronja (d), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/ 15, qeshor 2008", në bazë të nenit 13 , nenit 23, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.02/441 datë:14.09.2023, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -I- (parë) të rregullt të mbajtur me datë: 26.01.2024 merr këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË KOMITETIT PËR ARSIM KULTURË RINI DHE
SPORT PËR VITIN 2023

1. Miratohet Raporti nr.02/21 datë 12.01.2024 i Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport për vitin 2024.
2. Raporti përfshinë gjithë punët dhe aktivitetet që janë organizuar në vitin 2023 nga Komitetit për për arsim, kulturë, rini dhe sport.
3. Pjesë përbërse e këtij vendimi është Raporti të Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport për vitin 2023.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kuvendi i Komunës, përmes Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport .
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në auteritetin mbikqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, dhe pas shpalljes ne ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :
MAPL-së
Arkivit të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Thaçi



REPUBLIKA E KOSOVES
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË
Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport



Për: Kuvendi Komunal
Nëpërmjet: Kryesuesi Argjend Thaçi
Kopje për: Kryetari Ekrem Kastrati
Data: Dhjetor 2023

PRANUAR MË
ACCEPTED ON: 12.01.2024
PRIMLJENO: 02/21
MFM/RB:

Lënda: Raporti për vitin 2023

Mbledhja e parë e Komitetit është mbajtur me 17 mars 2023.

- U diskutua rreth Raportit të punës për Vitin 2022.
- U diskutua edhe rreth Planit të punës për Vitin 2023.
- Nga kjo mbledhje doli **Rekomandimi**:
Gjatë përzgjedhjes së drejtorëve të Institucioneve arsimore, kulturore, ... të merret parasysh meritokracia, e jo lidhjet politike, familjare apo të tjera.
- **U takuam me Kryetarin e Komunës, z. Ekrem Kastrati.**
Me Kryetarin biseduam për gjendjen në arsim dhe u pajtuam për nevojën e angazhimit të përbashkët në përmirësimin e gjendjes.





REPUBLIKA E KOSOVES
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË
Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport



- U takuam edhe me Komandantin e Stacionit të Policisë në Malishevë, kapitenin Azem Krasniqi.
Me Komandantin biseduam për gjendjen e sigurisë në Komunën tonë, me theks të veçantë për gjendjen e sigurisë në shkolla dhe rreth tyre.
Komandanti u tregua i interesuar dhe i gatshëm për angazhim në përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes së sigurisë.





REPUBLIKA E KOSOVES
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË
Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport



Mbledhja e dytë është mbajtur me 14 prill 2023

- Në rend dite kishim njoftimin e DKA-së rreth përgatitjeve për Testin e arritshmërisë dhe për Provimin e maturës.
Nga DKA-ja nuk u paraqit askush dhe nuk kishim as arsytim pse nuk kanë ardhur.

Vizituam Çerdhen për fëmijë “Zërat e ëmbël” në Malishevë.

U pritëm nga drejtoresha Behare Gashi-Shala.

E vizituam edhe aneksin e Çerdhes, që sipas drejtoreshës pritet të inaugurohet së shpejti.

- Në plan kishim edhe vizitën e Qendrës rinore por Zyra ishte mbyllur.
Zyrtari i Shtëpisë së kulturës na tha që askush nuk rrin rregullisht.
- **Rekomandim:**
 1. Në Provimin e maturës, edhe maturantët e Shkollës së Kijevës të mbajnë provimin në Malishevë.
 2. Të ketë kontroll më rigoroz gjatë mbajtjes së Testit të arritshmërisë dhe të Provimit të maturës.





REPUBLIKA E KOSOVES
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË
Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport



Mbledhja e tretë është mbajtur me 12.05.2023

- Në rend dite kishim pikën e përsëritur nga mbledhja e kaluar:
Përgatitjet për organizimin e Testit të arritshmërisë dhe Provimit të maturës,
Njoftim për listën e përfituesve të bursave për studentë
Nga DKA-ja i pranishëm ishte shefi Sabit Berisha, i cili njoftoi:
Këtë vit, rregullat do të jenë më ndryshe – nga 15 nxënës në klasë.
Testi arritshmërisë mbahet në datat 04 dhe 11. 07 2023
Mbahet në 6 qendra, dhe pritët që testit t'i nënshtrohen 848 nxënës.
Janë të angazhuar 65 administrues, 10 mbikqyrës dhe 18 komisionerë(mësimdhënës).
Për Provimin e maturës ende nuk janë caktuar datat. Duhet të presim përfundimin e vitit
mësimor e të shohim sa e fitojnë të drejtën(që kalojnë) me hy në provim.
Për bursa, janë nda gjithsej 95.000 euro(nga 300 euro).
Kanë qenë 20 ankesa, janë shqyrtue dhe kanë përfutue edhe ata.
Shefi i DKA-së: nga Gjimnazi ishin në ekskursion në Shqipëri 365 nxënës, nga 130 euro =
47.450 euro. Më mirë të kishin mbetë në Kosovë këto mjete.
E kemi biseduar edhe me Kryetarin: është treni i fundit që keqpërdorimet eventuale duhet të
ndalen.
Rekomandime:
1. Bursat të ndahen me kriterin e notës mesatare
2. Të merret iniciativa për fillimin e organizimit të ekskursioneve nëpër Kosovë
Pas mbledhjes, vizituam dy shkolla:
- **SHFMU “Ganimete Terbeshi” në Astrazub**
U pritëm nga drejtori Milaim Morina, i cili njoftoi:
Shkolla ka 247 nxënës, të shpërndarë në 20 paralele(mesatarisht 12.35 nxënës për paralele).
Gjithsej 36 punëtorë, nga të cilët 30 mësimdhënës.
Nuk kemi kamera të sigurisë.
Mungon rrethoja e oborrit dhe rruga e pa shtruar brenda oborrit.
E kemi kabinetin e informatikës, ndërsa për laboratore nuk kemi mjete.
Rekomandime:
1. Të rregullohen rrethoja e oborrit dhe rruga e pa shtruar brenda oborrit



REPUBLIKA E KOSOVES
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË
Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport



- **ShFMU "Emin Duraku" në Dragobil**

Shkolla ka 247 nxënës, të shpërndarë në 15 paralele (mesatarisht 16.46 nxënës për paralele). Gjithsej 28 punëtorë, nga të cilët 25 mësuesdhënës.

Kemi një kabinet të informatikës me 24 kompjuterë – donacion, 16 nuk kanë qenë funksional.

Rrjet nuk kemi, e kemi instaluar ne vetë.

Uji dhe ngrohja – mirë.

Laboratori për kimi, fizikë dhe biologji, ka mjete.

Për muzikë, pak mjete. Edhe për edukatë fizike, pak mjete.

Mjete higjienike, ka me rregull. Më herët të dobëta, e tash edhe cilësore.

Shujta ushqimi parafillorë nuk kanë, e klasët I-V kanë.

Rekomandim:

1. Të ndahen më shumë mjete për internet dhe për kabinet të informatikës

Mbledhja e katërt është mbajtur me 29.05.2023

Në rend dite kishim pikën: Njoftim i DKR-së rreth përgatitjeve për Ditën e Çlirimit dhe të Dëshmorëve (16 Qershori)

Në mbledhje do të duhej që dikush nga DKRS-ja të paraqitet për njoftim rreth kësaj pike të rendit të ditës, por nuk u paraqit askush.

Drejtori Fitim Shala është arsyetuar nëpërmjet zyrtares se është i zënë në mbledhjen e Këshillit organizativ për Ditën e Çlirimit.

Pas mbledhjes, vizituam dy shkolla:



REPUBLIKA E KOSOVES
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË
Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport



Shkolla e mesme profesionale “Lasgush Poradeci” në Kijevë

U pritëm nga drejtori Burim Gashi, i cili na njoftoi:

Të regjistruar në fillim të vitit – 302 nxënës. Në fund të gj.vjetorit të parë – 268 nxënës.

785 orë të humbura apo 39.25 norma mësimore.

8218 mungesa të nxënësve apo 30.66 për nxënës.

Me ujë kemi qenë në rregull. Me ngrohje kemi pasë telashe.

Me kushtet higjienike, furnizimi ka qenë i mirë.

Kabineti i informatikës dhe laborator për biologji, kimi dhe fizikë janë funksional.

Laborator të mjekësisë nuk kemi (24 nxënës – 23 F dhe 1 M).

Për art muzikor dhe art figurativ nuk kemi kabinete.

As sallë të edukatës fizike nuk kemi.

Rekomandim:

1. Të investohet më shumë për nxemje si dhe për kabinete, laboratore dhe sallë të edukatës fizike.

SHFMU “Kajtaç Ramadani” në Kijevë

U pritëm nga drejtori Bedri Toplana, i cili na informoi:

Të regjistruar në fillim të vitit – 348 nxënës, së bashku me dy paralelet e ndara

Në Stapanicë – 124 nxënës, e në Gullboc – 85 nxënës.

Gjithsej 54 punëtorë: 47 mësimdhënës, Drejtori, Sekretari dhe 5 punëtorë teknik.

Furnizimi me ujë, është i mirë. Me rregullimin e banjove, gjendja nuk është e mirë.

Me ngrohje, kemi problem me kalldajën – duhet me e ndrrue.

Kabinetet – në rregull, edhe për gjuhë angleze dhe gjermane, por jo edhe për art muzikor dhe art figurativ. Laboratori – në rregull. Salla e edukatës fizike – po.

Paisje higjienike – në rregull, pa probleme.

Kamerat funksionojnë mirë.

Përgjegjësitë e dy paraleleve të ndara janë me norma të plota.

Rekomandim:

- Të krijohet mundësia që përgjegjësitë e paraleleve të punojnë me nga gjysmë norme mësim.

- Të rregullohet çështja e nxemjes(kalldaja)

Mbledhja e pestë është mbajtur me 09.06.2023

Në rend dite kishim pikën: Njoftim i DKRS-së rreth përgatitjeve për Ditën e Çlirimit dhe të Dëshmorëve (16 Qershor).

Drejtori i DKRS-së Fitim Shala na informoi për përgatitjet:

Aktivitetet fillojnë nga sot. E kemi publikuar agjenden për 16 Qershorin.

Me 16 Qershor, nga ora 10 Marshi nga Komuna deri te Kompleksi i varrezave të dëshmorëve – Marshojmë për Dëshmorët.

Në ora 11, përurimi i bulevardit.



REPUBLIKA E KOSOVES
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË
Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport



Me kërkesën tonë, Drejtori i lexoi të nominuarit për tri çmimet që do të ndahen me 16 Qershor.

Rekomandimi(i përseritur nga viti i kaluar):

1. Propozojmë që në vitin 2024, profesori Haxhi Samadraxha të nominohet për Çmimin "Hamdi Berisha"(post mortum).

Pas mbledhjes, i vizituam dy shkolla:

SHFMU "Hasan Prishtina" në Terpezë

U pritëm nga drejtoresha Emine Krasniqi, e cila na njoftoi:

Nxënës të regjistruar – 135, kanë vijuar 133, e tash janë 130.

Janë 20 punëtorë, nga të cilët 17 mësimdhënës.

Gjendja me ujë – e mirë, me ngrohje e mirë.

Kushtet higjienike – të mira.

Mjete mësimore për nxënës(aktivitete) – fare pak.

Kabineti i informatikës, në një hapësirë me bibliotekën.

Mjete për laborator ka por hapësirë nuk ka.

Edhe për kabinet të muzikës ka mjete por nuk ka hapësirë.

Pra, kemi mungesë të hapësirës për kabinete dhe laboratore.

Fushë të sportit kemi por nuk kemi sallë të edukatës fizike.

Rekomandime:

1. Të zgjidhet çështja e hapësirës për kabinete, laboratore dhe bibliotekë, si dhe salla e edukatës fizike

SHFMU "Rifat Berisha" në Berishë

U pritëm nga drejtori Eshref Berisha, i cili na njoftoi:

Numri i nxënësve të regjistruar – 95. Vijnë 92, të shpërndarë në 10 paralele(me parashkollor).

Të angazhuar 19 punëtorë, nga të cilët 16 mësimdhënës.

Kabinete nuk kemi(as të informatikës).

Biblioteka është në shkollën e vjetër, ku gjendja është e mjerueshme.

Fushë të sportit nuk kemi. Oborri i shkollës, në gjendje jo të mirë.

Gjendja me ujë, e mirë(me pus).

Ngrohja – ka nevojë për kalldajë më të madhe.

Me material higjienik, jemi mirë.

Për printer dhe fotokopje nuk kemi ngjyrë.

Interneti, vetëm në zyre.

Rekomandim:

-Të rregullohen:

Oborri i shkollës

fusha e sportit,

nxemja(kalldaja)

si dhe kabineti i informatikës dhe biblioteka



Klubi i atletikës “Malisheva” në Malishevë

Edhe pse në muajin korrik ishim në pushim si Komitet, në cilësinë e kryesuesit, me datë **24.07.2023** vizitova klubin e atletikës ku u pritja nga trajneri i klubit, kolegu nga Gjimnazi profesori Adrian Mazreku.

Edhe pse ditë me vapë, atletët vazhdojnë ushtrimet e rregullta me 6 ditë në javë, vetëm e diela e lirë. Trajneri më informoi që po bëhen përgatitjet për Kampionatin Ballkanik dhe Evropian që mbahen në gusht dhe në shtator.

Ai poashtu më informoi edhe për rezultatet (sukseset) e klubit.

Trajneri pati një kërkesë:

1. Të gjendet një zgjidhje që të na mundësohet të kemi një punëtor që merret me pastrimin e hapësirave të stadionit, pjesës ku i realizojmë ushtrimet.

Është vështirë që të merremi me ushtrimet dhe vet ta pastrojmë fushën.





Mbledhja e gjashtë është mbajtur me 29.08.2023

Në rend dite kishim dy pika:

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të DKA-së për vitin mësimor 202/23

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të gjashtë mujorit të parë të DKRS-së për vitin 2023

Askush nga DKA-ja nuk u paraqit për të raportuar.

Nuk kemi pranuar asnjë njoftim me arsyetimin pse nuk është paraqitë, edhe pse kanë qenë të njoftuar me kohë.

Nga DKRS-ja, as nuk e kanë dërguar raportin e as nuk është paraqitë askush për raportim.

Për raportin janë arsyetuar që zyrtarët përgjegjës janë në pushim.

Edhe pse nuk ishte askush nga DKA-ja, unë shkurtimisht përmenda që:

Edhe pse Raport për vitin mësimor, shumica e të dhënave statistikore janë vetëm për gj.vjetorin e dytë.

Nga të dhënat në raport, shihet që ka shumë mungesa të nxënësve dhe shumë mungesa të mësimdhënësve.

Edhe Testi i arritshmërisë, edhe Provimi i maturës janë me rezultat nën 50%.

Të gjitha këto të dhëna, tregojnë që të gjithë së bashku duhet të merremi më seriozisht me gjendjen.

Pas mbledhjes shkuam në DKA për urime me rastin e fillimit të Vitit shkollor 2023/24.

U pritëm nga shefi i DKA-së Sabit Berisha me bashkëpunëtorë.

Duke dalë nga DKA-ja, erdhi edhe drejtoresha Arbëreshë Krasniqi.

Mbledhja e shtatë është mbajtur me 15.09.2023

Në rend dite kishim dy pikat e bartura nga mbledhja e kaluar, pasi që as nga DKA-ja e as nga DKRS-ja nuk u paraqitën për raportim.

Nga DKA-ja, as sot nuk u paraqit askush.

Nuk kemi asnjë arsyetim pse ndodhi që dy mbledhje rresht nuk paraqitet askush për raportim.

Ndërsa Raportin e gjashtë mujorit të parë të DKRS-së për vitin 2023 e paraqiti drejtori Fitim Shala.

Ai iu përgjigj edhe pyetjeve të parashtruara nga anëtarët e Komitetit.

Pas mbledhjes, kishim në plan të vizitojmë: Pallatin e sportit, Pallatin e kulturës dhe Qendren e rinisë. Por Drejtori na tha që dy pallatet janë duke u renovuar ndërsa Qendra e rinisë nuk ka punëtor të përhershëm dhe mund të mos e gjeni askend aty.

- Sa i përket Raportit të DKA-së, edhe pse në mungesë të përfaqësuesve nga DKA-ja unë paraqita para anëtarëve të Komitetit disa të dhëna nga Raporti:



Raport nga DKA

Viti shkollor 2022/23

Edhe pse Raporti është për Vitin shkollor, në të dhënat statistikore shkruhet - vetëm për Gj.vjetorin e dytë.

Derisa nuk patëm përfaqësues të DKA-së për ta sqaruar, nuk e dimë si ta marrim: Raport të vitit shkollor apo të gj.vjetorit të dytë.

- **Mungesat:**

I – IV = 59.448

VI – IX = 105.121

X – XII = 90.129

Gjithsej = 254.698 / Nëse e pjestojmë për 32(sa është numri i mungesave që largohet nxënësi), del që 7.959 nxënës do duhej të largoheshin nga shkolla, nga gjithsej 9.213 nxënës sa ka në fund të këtij viti mësimor.

- **Orët e humbura:**

I-V = 13.114

VI- IX = 17.538

X – XII = 12.114

Gjithsej – 42.766 / Nëse e pjestojmë me 20(sa është norma e një mësimdhënësi), del që brenda këtij Viti kanë humbur 2.138 norma mësimore.

Është shqetësues fakti që këto të dhëna, sipas këtij Raporti thuhet që janë vetëm për Gj. vjetorin e dytë, pra, jo për Vitin shkollor.

Uroj që të ketë ndonjë gabim gjatë hartimit të Raportit! Përndryshe ...



REPUBLIKA E KOSOVES
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË
Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport



Pas mbledhjes, i kam njoftuar Kryesuesin dhe Kryetarin për mos paraqitjen e zyrtarëve të DKA-së në dy mbledhjet e fundit.

Kjo nuk është hera e parë, pasi që kështu ka ndodhë edhe vitin e kaluar.

Gjendja në arsim ka nevojë për angazhim, bashkëpunim dhe koordinim të shtuar ndërmjet Kryetarit, DKA-së, Kuvendit dhe Komitetit për arsim, ...

Mbledhja e tetë është mbajtur me 23.10.2023

Në rend dite ishte Takimi me Kryetarin e Komunës

Meqenëse në ndërkohë Kryetari kishte një organizim për barazi gjinore, takimi ishte anulue nga stafi i tij.

Anëtarët e Komitetit kërkuar nga unë që të takohem me Kryetarin në emër të Komitetit.

U pajtuam që në mbledhjen e ardhshme të bisedojmë për përgatitjen e Raportit të punës për vitin 2023, si dhe për Planin e punës për vitin 2024.

U paraqit shqetësimi ynë për pagesën e anëtarëve të Komitetit, ngase këtë vit nuk është paguar asnjë medij për mbledhjet e mbajtura deri me tash.

Këtë shqetësim, në emër të Komitetit iu kam paraqitë zyrtarisht edhe Kryesuesit të Kuvendit dhe Kryetarit të Komunës, pasi që ka trupa të Kuvendit që janë paguar.

Pas mbledhjes, i vizitua dy shkolla:

SHFMU “Habib Berisha” në Gurbardh

U pritëm nga drejtori Bekim Berisha, i cili na njoftoi:

Shkolla ka 251 nxënës, të shpërndarë në 19 paralele.

Të angazhuar 31 punëtorë, nga të cilët 28 mësimdhënës.

Punohet në një ndërrim.

Kushtet higjienike, shumë të mira. Furnizimi me ujë, në rregull.

Nxemja – një pjesë nuk ka ose ka pak, sepse kapaciteti i kalldajes është i vogël.

Kabinete po, laboratore jo. Fotokopja nuk punon.

Biblioteka po. Do të shpërblehen nxënësit që lexojnë më shumë (mirënjohje apo komplet librash).

Interneti – 3 muaj nuk kemi pasë. Tash është funksional, vetëm në zyrë të Drejtorit e ne mandej e shpërndajmë.

Rekomandim:

1. Të zgjidhet çështja e nxemjes (kalldaja) si dhe e fotokopjes



REPUBLIKA E KOSOVES
KUVENDI I KOMUNES NË MALISHEVË
Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport



SHFMU "18 Prilli" në Burim

U pritëm nga drejtori Afrim Morina, i cili na njoftoi:

Shkolla ka 120 nxënës, të shpërndar në 10 paralele.

Të angazhuar 23 punëtorë, nga të cilët 20 mësimdhënës.

Punohet në dy ndrrime.

Bibliotekë dhe kabinet të informatikës, në një vend me një hapësirë shumë të vogël.

Laborator nuk ka, shkak i mungesës së hapësirës.

Ngrohja funksionon mirë. Furnizimi me ujë, me ujësjellës dhe kur ndalet mbesim keq.

E kemi një gjenerator që e kemi sigurue me donacion.

Fotokopja dhe printeri funksionojnë mirë.

Interneti nuk ka funksionuar në 6-7 muajt e fundit.

Inventari është mangu.

Mjete higjienike këtë vit ende nuk kemi pranuar. Po marrim vetëm 7 ngapak.

Rekomandim:

1. Të zgjidhet çështja e hapësirës për kabinet të informatikës dhe bibliotekë si dhe inventar



REPUBLIKA E KOSOVES
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË
Komiteti për arsim, kulturë, rinë dhe sport



Mbledhja e nëntë është mbajtur me 29.11.2023

Në rend dite ishte: Përgatitjet për hartimin e Raportit të punës për vitin 2023, si dhe të Planit të punës për vitin 2024.

Të pranishëm 4 anëtarë.

Për Raportin e punës për vitin 2023 dhe për Planin e punës për vitin 2024, u pajtuam që Kryesuesi me punu propozimin(draftin) dhe me iu përcjellë anëtarëve të Komitetit dhe ata me shtu apo me sygjerime eventuale me e plotësue.

Pas kësaj, të miratohen në mbledhjen e ardhshme.

Anëtarët e Komitetit i njoftova për mungesën e komunikimit me Kryesuesin dhe me Kryetarin.

Asnjëri nuk më kanë kthye përgjigje, as për mos pagesën e meditjeve(asnjë për këtë vit) e as për kërkesën për takim me Kryetarin, sipas kërkesës së anëtarëve që të takohem me te.

Nuk ka ndodhë herave tjera që deri në fund të vitit të mos paguhet asnjë meditje, e aq më tepër të mos ketë as përgjigje(sqarime).

Pas mbledhjes, i vizituam dy shkolla:

SHFMU “17 Shkurti” në Banjë

Nga Komiteti ishim: Unë, Fjoralba dhe Arbnora.

U pritëm nga drejtori Izahir Begaj, i cili na njoftoi:

Shkolla i ka 166 nxënës(ka rënie), të shpërndarë në 10 paralele.

I ka 21 punëtorë, nga të cilët 18 mësimdhënës.

Besarta Fetahu është në listë të pagave por kurrë nuk ka punuar tek ne.

Edhe Besarta Ramaj është në listë të pagave por këtë vit nuk punon te ne.

Nxemja është në rregull. Ka pasur probleme por tash është mirë.

Uji – në rregull, me ujësjellës.

Kabinet të TIK-ut kemi.

Laboratore – mjete ka por hapësirë nuk ka.

Salla e edukatës fizike po pikon në disa vende.

Material higjienik – në rregull.

Fotokopja dhe printeri punojnë copa copa(herë herë)

Problemin më të madh e kemi me rrethojën e oborrit. Është shumë e dobët dhe qentë po na nxjerrin telashe, sidomos me nxënësit që po frigohen me ardhë dhe me dalë pa përcjellje.

Rekomandim:

1. Të zgjidhet çështja e rrethojës së oborrit.



REPUBLIKA E KOSOVES
KUVENDI I KOMUNES NË MALISHEVË
Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport



Galaxy A52s 5G



REPUBLIKA E KOSOVES
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË
Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport

SHFMU “28 Nëntori” në Kravasari

U pritëm nga drejtoresha Shkendie Hoxha-Bytyçi, e cila na njoftoi:

Shkolla i ka 122 nxënës, të shpërndarë në 10 paralele.

I ka 19 punëtorë, nga të cilët 16 mësimdhënës.

Internet nuk ka në gjithë shkollën. Nëpër klasa nuk ka.

Kabinet të informatikës nuk kemi.

Laboratore nuk kemi, megjithëse kemi pak mjete por nuk kemi hapësirë.

Material higjienik ende nuk kemi marrë këtë vit por ende kemi.

Nxemja – në dy klasë në këtë objekt dhe në objektin tjetër nuk punon mirë.

Uji – me ujësjellës, mirë por sanitaria brenda është e dëmtuar.

Kanalizimi – problem, aroma e keqe.

Fotokopja dobët. Printer, një në zyren time.

Kamerat e sigurisë i kemi.

Sallë të edukatës fizike nuk kemi por kemi fushë të sportit.

Rryma – kemi problem me rrjetin në shkollë.

Rekomandim:

1. Të zgjidhen çështja e rrymes, nxemjes, kanalizimit, internetit dhe kabinetit të informatikës





REPUBLIKA E KOSOVES
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË
Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport



Mbledhja e dhjetë është mbajtur me 18.12.2023

Në rend dite ishin:

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës për vitin 2023

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës për vitin 2024

Të pranishëm ishin 4 anëtarë. Mungoi Asim Rudi.

Pas shqyrtimit, si Raporti për vitin 2023 ashtu edhe Plani për vitin 2024, u miratuan unanimitisht, dhe mbeti që pas përfshirjes edhe të kësaj mbledhje dhe vizitës në shkollë, kopjet e printuara të Raportit dhe të Planit të dorëzohen në Zyren e pranimi dhe të protokolohen e t'u dërgohen Kuvendit (nëpërmjet Kryesuesit) dhe Kryetarit.

Pas mbledhjes vizituar: